

GJYKATA THEMELORE NË PEJË

P.nr. 38/12

Data: 23 Janar 2013

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Pejë, në Trupin Gjykses të përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it Dariusz Sielicki si Kryetar i Trupit Gjykses, Gjyqtari i EULEX-it Malcolm Simmons dhe Gjykatësi i Kosovës Shaban Shala si anëtarë të Trupit Gjykses, të asistuar nga procesmbajtësja Nexhmije Mezini, në lëndën penale kundër të akuzuarit:

1. **BN** biri i XX, i lindur më XX 1973 në XX, me banim në fshatin XX, Komuna e XX, banor i Republikës së Kosovës, në paraburgim që nga data e arrestimit të tij më 10 qershor 2011 deri 1 qershor 2012, kur ai u lirua me dorëzani,
2. **NB**, biri i XX, i lindur më XX 1986 në XX, me banim në fshatin XX, Komuna e XX, banor i Republikës së Kosovës, në paraburgim që nga data e arrestimit të tij më 10 qershor 2011 deri 1 qershor 2012, kur ai u lirua me dorëzani,
3. **BB**, biri i XX, i lindur më XX 1983 në fshatin XX, Komuna XX, me banim në fshatin XX, Komuna e XX, banor i Republikës së Kosovës, në paraburgim që nga data e arrestimit të tij më 10 qershor 2011 deri më 1 qershor 2012, kur ai u lirua me dorëzani,
4. **AB** biri i XX, i lindur më XX 1969 në fshatin XX, Komuna e XX, me banim në fshatin XX, Komuna e XX, banor i Republikës së Kosovës, në paraburgim nga data e arrestimit të tij më 13 qershor 2011 deri më 29 qaj 2012, kur ai u lirua në arrest shtëpiak e cila u ndërpre më 20 Nëntor 2012,
5. **AZB**, biri i XX, i lindur më XX 1985 në XX, me banim në fshatin XX, Komuna e XX, shtetas i Republikës së Kosovës, në paraburgim që nga data e arrestimit të tij më 11 qershor 2011 deri më 29 maj 2012, kur ai u lirua në arrest shtëpiak e cila u ndërpre më 20 nëntor 2012,
6. **MB** biri i XX, i lindur më XX 1957 në fshatin XX, Komuna e XX, me banim në fshatin XX, banor në fshatin

XX, Komuna e XX Republika e Kosovës, në paraburgim që nga data e arrestimit të tij më 11 qershor 2011 deri më 31 maj 2012, kur ai u lirua me dorëzani,

7. **SB** biri i XX, i lindur më XX 1969 në fshatin XX, Komuna e XX, me banim në XX, Komuna e XX, banor i Republikës së Kosovës, në paraburgim që nga data e arrestimit të tij më 10 qershor 2011 deri më 29 maj 2012, kur ai u lirua në arrest shtëpiak e cila u ndërpre më 20 nëntor 2012,
8. **AP** bir i XX, i lindur më XX 1978 në XX, me banim në fshatin XX, banor i Republikës së Kosovës
9. **ZZ** i njohur si "Z", i biri i XX, i lindur më XX 1983 në XX, me banim në fshatin XX, Komuna e XX, banor i Republikës së Kosovës

të akuzuar me Aktakuzën e Prokurorisë Speciale të Kosovës (PSRK) PPS.no.11/11, datë 28 Tetor 2011 me aktin si në vijim:

se nga një datë e papërcaktuar deri me 10 qershor 2011, duke vepruar në një grup të strukturuar, me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore dhe duke rrezikuar jetën dhe sigurinë e migrantëve, ata kanë kontrabanduar shtetas të Republikës së Kosovës, në mënyrë të tillë që ata gjetën Migrantë të interesuar për të shkuar në vende të ndryshme Evropiane, ata ranë dakord për çmimin që emigrantët duhet paguar, çmimet ishin në shumën prej 1500 Euro deri në 3000 Euro për person dhe pastaj të njëjtit migrantë u dërguan ilegalisht, përmes njerëzve të ndryshëm në Serbi, disa prej tyre përmes Serbisë dhe Hungarisë dhe disa prej tyre nëpërmjet Malit të Zi, Kroacisë dhe Sllovenisë, në vende të ndryshme Evropiane, në mesin e këtyre migrantëve ishin EI, BT, SB, FF, IV, AK, AM, IH, IP, LC, BA, AT, PV, ZH, SV, BV, MH, si dhe migrantë të tjerë të paidentifikuar,

veprimet e përmendura të tyre janë klasifikuar vepra penale si në vijim:

- Krim i Organizuar, sipas Nenit 274 paragrafi 2 lidhur me Nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), sepse ata kanë marrë pjesë në mënyrë aktive në aktivitete kriminale apo aktiviteteve tjera të një grupi të organizuar kriminal, duke ditur se pjesëmarrja e tyre do të

kontribuojë në kryerjen e krimeve të rënda nga ana e grupit të organizuar kriminal;

- Kontrabandë me Migrantë, sipas Nenit 138 paragrafi 6, në lidhje me Nenin 23 të KPK-së, pasi vepra penale është kryer në mënyrë të tillë e që rrezikoi jetën dhe sigurinë e migrantëve,

Pas mbajtjes se seancave të shqyrtimit kryesor me dyer të hapura më 10, 23, 24, 29 dhe 31 maj 2012, 24 dhe 25 korrik 2012, 6, 8, 14, 15 dhe 20 nëntor 2012 dhe më 22 dhe 23 janar 2013, në prani të:

- Akuzuarit BN dhe Gëzim Kollçakut, Avokat i tij Mbrojtës
- Akuzuarit NB dhe Lumturije Hoxha, Avokate i tij Mbrojtëse,
- Akuzuarit BB dhe Xhelal Radoniqit, Avokat i Mbrojtës,
- Akuzuarit AB dhe Flamur Kelmendit, Avokat i tij Mbrojtës
- Akuzuarit AZB dhe Ismet Hysenit Avokat i tij Mbrojtës,

3

- Akuzuarit MB dhe Bajram Tmava, Avokat i tij Mbrojtës,
- Akuzuarit SB dhe Muharem Hotit, Avokat i tij Mbrojtës,
- Akuzuarit AP dhe Behar Ejupit e Sevdali Zejnullahut Avokatë të tij Mbrojtës,
- Akuzuarit ZZ dhe Ekrem Agushit, Avokati i tij Mbrojtës,

- Pas këshillimit të Trupit Gjykses të mbajtur më 23 janar 2013, në bazë të Nenit 391 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës të datës 6 Nëntor 2008 (KPPK);

më 23 Janar 2013, në pajtim me Nenin 392 paragrafi 1 të KPPK, shpall në publik, si në vijim:

AKTGJYKIM

I. BN është fajtor sepse:

- në mes 01 qershor 2011 dhe 10 qershor 2011, në territorin e Republikës së Kosovës, me qëllim të marrjes për vete përfitim material prej 1800 Euro ai ka kontrabanduar BT, shtetas i Republikës së Kosovës, i cili nuk ka qenë banor i përhershëm ose shtetas i ndonjë shteti ne zonën Schengen, nga territori i Republikës së Kosovës në territorin e Republikës së Austrisë duke rregulluar transportimin për të me autobus dhe ka duke lehtësuar për të në

një mënyrë të papërcaktuar të hyrjes së tij në Zonën Schengen, pa i përmbushur kërkesat e nevojshme për hyrjen e ligjshme nëpërmjet kufirit midis Serbisë dhe zonës Shengen,

me këtë BN ka kryer vepra penale të Kontrabandimit me Migrantë sipas Nenit 170 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës të 20 prill 2012 (CCRK);

Prandaj, në këtë mënyrë

dënohet

4

sipas Nenit 170 paragrafi 1 të KPRK me 2 (dy) vjet burgim dhe gjobë në shumën prej 3000 Euro (tre mijë).

II. NB është fajtor sepse:

1. në mes 1 janarit 2011 dhe prill 2011, në territorin e Republikës së Kosovës, me qëllim të marrjes për vete të përfitim material prej 5400 euro ka kontrabanduar PV, BV dhe ZH, shtetas të Republikës së Kosovës, të cilët nuk ishin banorë të përhershëm apo shtetas të ndonjë shteti në Zonën Schengen nga territori i Republikës së Kosovës në territorin e Hungarisë me rregullimin e transportit për ta me autobus në Republikën e Serbisë nga ku ata shkuan këmbë përtej kufirit me Hungarinë, pa përmbushur kërkesat e nevojshme për hyrjen e ligjshme në Zonën Schengen;
2. në prill të vitit 2011, në territorin e Republikës së Kosovës, me qëllim të marrjes për vete të përfitim material në shumën prej 2200 Euro ka kontrabanduar SV, shtetas i Republikës së Kosovës, i cili nuk ka qenë banor i përhershëm ose shtetas i Zonës Schengen, nga territori i Republikës së Kosovës në territorin e Republikës së Austrisë me rregullimin e transportit për të me autobus për në Serbi nga ku ai vazhdoi këmbë përmes kufirit me Hungarinë pa i përmbushur kërkesat e nevojshme për hyrjen e ligjshme në Zonën Schengen dhe pastaj u transportuan me kamion në territorin e Republikës së Austrisë;

3. më 10 qershor 2011, në territorin e Republikës së Kosovës, me qëllim të marrjes për vete përfitim material në shumën prej 4000 Euro ai u përpoq për të kontrabanduar SB dhe FF, shtetas të Republikës së Kosovës, të cilët nuk ishin banorë të përhershëm apo shtetas të Zonës Schengen, nga territori i Republikës së Kosovës në territorin e Republikës së Austrisë duke e pajisur SB me pasaportë të vërtetë nr. 0046 76057 të HK, lëshuar nga Republika Federale e Jugosllavisë, e ndryshuar nga një person të paidentifikuar duke ia zëvendësuar fotografinë e mbajtësit të ligjshëm me fotografi të SB dhe duke e pajisur FF me pasaportë të vërtetë Nr. 0046 76057 të BT, lëshuar nga Republika Federale e Jugosllavisë, e ndryshuar nga MB duke zëvendësuar fotografinë e mbajtësit të ligjshëm me fotografi të FF, dhe rregullimin e transportimit me autobus të SB dhe FF në Republikën e Serbisë nga ku ata kishin për të shkuar këmbë përmes kufirit me Hungarinë pa i përmbushur kërkesat e nevojshme për hyrjen e ligjshme në Zonën Schengen dhe pastaj të transportohen në territorin e Republikës së Austrisë e cila nuk u realizua për shkak se SB dhe FF ishin ndaluar nga Policia e Kosovës gjatë kalimit të kufirit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë,

me këtë NB ka kryer në vazhdimësi, siç përcaktohet në Nenin 81 të KPRK:

- veprat penale të Kontrabandimit me Migrantë në kundërshtim me Nenin 170 paragrafi 1 të KPRK lidhur me veprat penale të përshkruara në II.1 dhe II.2;
- vepra penale të kontrabandimit me Migrantë në Tentativë sipas nenit 170 paragrafi 1 të KPRK dhe Nenit 28 Paragrafët 1 dhe 2 të KPRK lidhur me veprën penale të përshkruar në II.3,

Prandaj, në këtë mënyrë

dënohet

sipas Nenit 170 paragrafi 1 dhe Nenit 81 paragrafi 1 të KPRK, për veprat penale të përshkruara në II.1, II.2, dhe II.3 me 4 (katër) vjet burgim dhe gjobë në shumë prej 10 000 Euro (dhjetë mijë).

III: **BB** është fajtor sepse:

1. Në prill të vitit 2011, në territorin e Republikës së Kosovës, me qëllim të marrjes për vete përfitim material prej 1800 Euro, në bashkëpunim me AB, ai ka kontrabanduar AM, shtetas i Republikës së Kosovës, i cili nuk është banor i përhershëm ose shtetas i ndonjë shteti të Zonës Schengen prej territorit e Republikës së Kosovës në territorin e Republikës së Austrisë duke rregulluar për atë transport me autobus në Republikën e Serbisë nga ku ai vazhdoi këmbë përtej kufirit me Hungarinë pa përmbushur kërkesat e nevojshme për hyrjen e ligjshme në Zonën Schengen ,

2. Në mars të vitit 2011, në territorin e Republikës së Kosovës, me qëllim të marrjes për vete të përfitimit material në shumën 1650 euro dhe me ndihmën e ZZ, i cili i ka paguar atij shumën e lartpërmendur të parave, ka kontrabanduar në një mënyrë të papërcaktuar EI, shtetas i Republikës së Kosovës, i cili nuk ishte banor i përhershëm ose shtetas i Konfederatës Zvicerane nga territori i Republikës së Kosovës në territorin e Konfederatës së Zvicrës, pa përmbushur kërkesat e nevojshme për hyrje të ligjshme në këtë shtet,

me këtë BB ka kryer në vazhdimësi, siç përcaktohet në Nenin 81 të KPRK veprat penale të:

- Kontrabandimit me Migrantë në bashkëkryerje sipas Nenit 170 paragrafi 1 dhe Nenit 31 të KPRK lidhur me veprën penale të përshkruar në III.1;

 - Kontrabandimit me Migrantë sipas Nenit 170 paragrafi 1 të KPRK lidhur me veprën penale të përshkruar në III.2;
- Prandaj, në këtë mënyrë

dënohet

sipas Nenit 170 paragrafi 1 dhe Nenit 81 paragrafi 1 të KPRK, për veprat penale të përshkruara në III.1 dhe III.3 me 3 (tre) vjet burgim dhe gjobë në vlerë prej 4000 Euro (katër mijë)

IV. AB është fajtor sepse:

1. Në prill të vitit 2011 në territorin e Republikës së Kosovës, me qëllimi të marrjes së përfitimit material për vete shumë 1800 Euro në bashkëpunim me BB, ai ka kontrabanduar AM, shtetas i Republikës së Kosovës, i cili nuk ishte banor i përhershëm ose shtetas i ndonjë shteti i Zonës Schengen, nga territori i Republikës së Kosovës në territorin e Republikës së Austrisë me rregullimin për të, të transportit me autobus për në Serbi nga ku ai vazhdoi këmbë përmes kufirit me Hungarinë pa i përmbushur kërkesat e nevojshme për hyrjen e ligjshme në Zonën Schengen,

me këtë AB ka kryer veprën penale të:

- Kontrabandimit me Migrantë në bashkëkryerje sipas Nenit 170 paragrafi 1 dhe Nenit 31 të KPRK.

2. Në shtator të vitit 2010, në territorin e Republikës së Kosovës, me qëllim të marrjes për vete përfitim material në shumë 1100 Euro ka pajisur MH, shtetas i Republikës së Kosovës, i cili nuk ishte një shtetas ose banor i Zvicrës, me dokument të udhëtimit të falsifikuar duke e ditur se MH kishte për qëllim të përdorë atë për hyrjen në Turqi dhe më vonë në Zvicër pa përmbushur kërkesat e nevojshme për hyrjen e ligjshme në këto shtete, ndërsa i përmenduri MH ka përdorur dokumentin për këtë qëllim,

me këtë AB ka kryer veprën penale të:

- Kontrabandimit me Migrantë duke siguruar dokumente të falsifikuara të udhëtimit sipas Nenit 170 paragrafi 2 të KPRK.

Prandaj, në këtë mënyrë

dënohet

sipas Nenit 170 paragrafi 1 të KPRK, për veprën penale të përshkruar nën IV.1 me 2 (dy) vjet burgim dhe gjobë në vlerë prej 3000 euro (tre mijë);

sipas Nenit 170 paragrafi 2 të KPRK, për veprën penale të përshkruar nën IV.2 me 1 (një) vit burgim dhe gjobë në shumë prej 2000 Euro (dy mijë);

dhe sipas nenit 80 paragrafi 2 dhe nën-paragrafi 2.2 dhe 2.4 të KPRK për të dy veprat e përmendura lartë AB dënohet me 2 (dy) vjet dhe 6 (gjashtë) muaj burgim dënim unik, dhe dënim unik me gjobë në shumën prej 4000 (katër mijë) euro.

V. AZB është fajtor sepse:

1. Në shtator 2010, në territorin e Republikës së Kosovës, me qëllim të përfitimit material për veten e tij prej 2200 Euro, dhe me ndihmën e AP, i cili e kishte vënë në kontakt me IP, dhe i cili i kishte paguar atij shumën e parave të përmendura më lartë, e ka kontrabanduar IP, shtetas i Republikës së Kosovës, i cili nuk ka qenë banor i përhershëm apo shtetas i ndonjë nga shtetet e hapësirës Schengen, nga Republika e Kosovës në territorin e Republikës së Serbisë dhe pastaj në territorin e Austrisë pa përmbushur kërkesat e nevojshme për hyrje ligjore në hapësirën Schengen,
2. Në mes të 15 marsit 2011 dhe 15 prillit 2011, në territorin e Republikës së Kosovës, me qëllim të përfitimit material për veten e tij në shumë prej 2200 Eurove dhe me ndihmën e AP, i cili e kishte vënë në kontakt me LC, shtetas i Republikës së Kosovës, i cili nuk është banor i përhershëm apo shtetas i ndonjë nga shtetet e hapësirës Schengen, e ka kontrabanduar LC nga territori i Republikës së Kosovës në territorin e Republikës së Serbisë nga ku ai ka shkuar në këmbë në Hungari dhe pastaj në mënyrë të panjohur në territorin e Austrisë, pa i përmbushur kërkesat e nevojshme për hyrje ligjore në hapësirën Schengen.

me çka AZB ka kryer në vazhdimësi siç përcaktohet me nenin 81 të KPRK:

- veprat penale të Kontrabandimit me Migrantë sipas Nenit 170 Paragrafi 1 i KPRK-së;

prandaj, me anë të kësaj

dënohet

sipas Nenit 170 Paragrafi 1 dhe Nenit 81 Paragrafi 1 i KPRK-së, për veprat penale të përshkruara në V.1 dhe V.2 me 3 (tre) vjet burgim dhe me shumën prej 4000 (katër mijë) Euro gjobë.

VI. MB është fajtor:

sepse në mes 1 majit 2011 dhe 10 qershorit 2011, në territorin e Republikës së Kosovës, ka ndryshuar një dokument publik, domethënë një pasaportë të vërtetë nr. 0046 76057 të BT, të lëshuar nga Republika Federale e Jugosllavisë, duke e zëvendësuar përmes përdorimit të pincave fotografinë e mbajtësit legjitim me fotografinë e FF, me qëllim që ky dokument të përdoret si i vërtetë për kalimin e kufijve të Kosovës;

me çka MB ka kryer veprën penale të Falsifikimit të Dokumenteve sipas Nenit 332 Paragrafi 3 të KPK;

prandaj, në këtë mënyrë

dënohet

sipas Nenit 332 Paragrafi 3 i KPK-së me 1 (një) vit burgim dhe sipas Nenit 54 Paragrafi 1 dhe 2 nën paragrafi 1 i KPK-së me shumë prej 1000 (një mijë) Eurosh gjobë.

VII. **SB** është fajtor sepse:

1. Në vitin 2011, në territorin e Republikës së Kosovës, me qëllim të përfitimit material për veten e tij në shumë prej 3600 Eurosh, ka kontrabanduar BA dhe një mashkull tjetër të panjohur, shtetas të Republikës së Kosovës, të cilët nuk kanë qenë banorë të përhershëm apo shtetas të ndonjë shteti të hapësirës Schengen, nga territori i Republikës së Kosovës në territorin e hapësirës së Schengenit duke rregulluar transportimin e tyre me autobus në Republikën e Serbisë nga ku ata kanë shkuar këmbë përmes kufirit me Hungarinë pa i përmbushur kërkesat e nevojshme për hyrje ligjore në territorin e hapësirës Schengen.
2. Në mes të 1 janarit 2011 dhe 9 qershorit 2011, në territorin e Republikës së Kosovës, me qëllim të përfitimit material për veten e tij në shumë prej 1600 Eurosh, ka kontrabanduar një mashkull të paidentifikuar me emrin FI nga fshati XX, i cili ishte shtetas i Republikës së Kosovës dhe nuk ishte banor i përhershëm apo shtetas i ndonjë nga shtetet e hapësirës Schengen, nga territori i Republikës së Kosovës në territorin e hapësirës Schengen, duke rregulluar transportimin e tij me autobus në Republikën e Serbisë nga ku ai ka shkuar këmbë përmes kufirit me Hungarinë pa i përmbushur kërkesat e nevojshme për hyrjen ligjore në territorin e hapësirës Schengen.

me këtë SB ka kryer në vazhdimësi siç përcaktohet me Nenin 170 Paragrafi 1 të KPRK-së:

- veprat penale të Kontrabandimit me Migrantë sipas Nenit 170 Paragrafi 1 të KPRK:

prandaj, në këtë mënyrë

dënohet

sipas Nenit 170 Paragrafi 1, Nenit 75 Paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe Nenit 76 Paragrafi 1 nën paragrafi 1.4, dhe Nenin 81 Paragrafi 1 për veprat penale të përshkruara në Vii.1 2 dhe VII.2 me 1 (një) vjet dhe 6 (gjashtë) muaj burgim dhe shumë prej 500 (pesëqind) Euro gjobë.

VIII. **AP** është fajtor sepse:

1. Në shtator 2010, në territorin e Republikës së Kosovës, i ka dhënë ndihmë AZB i cili ka vepruar me qëllim të përfitimit material për veten e tij, në shumë prej 2200 Euro duke e vënë AZB në kontakt me IP, shtetas i Republikës së Kosovës, i cili nuk ishte banor i përhershëm apo shtetas i ndonjë nga shtetet e hapësirës Schengen dhe duke premtuar AP të paguajë i cili më pas ia paguan atij shumë prej 2200 Euro për kontrabandimin e IP nga territori i Republikës së Kosovës në territorin e Republikës së Serbisë dhe nga aty në territorin e Republikës së Austrisë pa i përmbushur kërkesat e nevojshme për hyrje ligjore në territorin e hapësirës Schengen.
2. Në mes 15 marsit 2011 dhe 15 prillit 2011, në territorin e Republikës së Kosovës, i ka dhënë ndihmë AZB, i cili ka vepruar me qëllim të përfitimit material për veten e tij në shumë prej 2200 Euro, duke vënë AZB në kontakt me LC, shtetas i Republikës së Kosovës, i cili donte të emigrojë ilegalisht nga Republika e Kosovës, ndërsa AZB e ka kontrabanduar LC i cili nuk ishte banor i përhershëm apo shtetas i ndonjërit nga shtetet e hapësirës Schengen, nga territori i Republikës së Kosovës në territorin e Republikës së Austrisë duke rregulluar për atë transportimin me autobus nga Republika e Kosovës në territorin e Republikës së Serbisë nga ku ai shkoi

këmbë në Hungari dhe më pas në një mënyrë të panjohur në territorin e Republikës së Austrisë, pa i përmbushur kërkesat e nevojshme për hyrje ligjore në territorin e hapësirës Schengen,

me këtë AP ka kryer në vazhdimësi, siç përcaktohet në Nenin 81 të CCRK- së

- veprën penale të Ndhmës për Kontrabandë të Migrantëve sipas Nenit 170 Paragrafi 1 dhe Nenit 33 Paragrafi 2 i CCRK-së;

Prandaj, në këtë mënyrë

dënohet

sipas Nenit 170 Paragrafi 1, Nenit 75 Paragrafi 1 nën Paragrafi 1.2 dhe Nenit 76 Paragrafi 1 nën Paragrafi 1.4, Nenit 33 Paragrafi 1, dhe Nenit 81 Paragrafi 1 të CCRK për veprat penale të përshkruara në VIII.1 dhe VIII.2 me 10 (dhjetë) muaj burgim dhe gjobë në shumën 500 (pesëqind) euroë

sipas Nenit 51 Paragrafi 2 dhe Nenit 52 Paragrafi 2 i KPRK dënimi me burgim i shqiptuar ndaj AP nuk do të ekzekutohet nëse AP nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, për periudhën e verifikimit prej 2 (dy) vitesh.

IX. **ZZ** është fajtor sepse:

në mars 2011, në territorin e Republikës së Kosovës, ai i ka dhënë ndihmë BB, i cili ka vepruar me qëllim të përfitimit material për veten e tij, në shumë prej 1650 Eurosh, duke premtuar për ta paguar atë dhe më pas ia ka paguar atij një shumë prej 1650 Eurosh për kontrabandimin e EI, një shtetas i Republikës së Kosovës, i cili nuk ishte banor i përhershëm ose shtetas i Konfederatës Zvicëre, nga territori i Republikës së Kosovës në territorin e Konfederatës së Zvicrës, pa i përmbushur kërkesat e nevojshme për hyrjen e ligjshme në atë vend.

Me këtë ZZ ka kryer vepër penale Ndhmë në Kontrabandimin me Migrantë sipas Nenit 170 Paragrafi 1 dhe Nenit 33 të CCRK-së;

Prandaj, në këtë mënyrë

dënohet

Sipas Nenit 170 Paragrafi 1, Neni 75 Paragrafi 1 nën Paragrafi 1 dhe Nenit 76 Paragrafi 1 nën Paragrafi 1.4, dhe Nenit 81 Paragrafi 1 të KPRK për veprat penale të përshkruara më lartë në pikën IX me 6 (gjashtë) muaj burgim dhe gjobë në shumën prej 300 (treqind) Euro;

Sipas Nenit 51 Paragrafi 2 dhe Neni 52 Paragrafi 2 të KPRK dënimi me burgim i shqiptuar ndaj ZZ nuk do të ekzekutohet nëse ZZ nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale për periudhën e verifikimit prej 1 (një) viti.

X. Sipas Nenit 46 Paragrafi 2 të KPRK afati për pagesën e gjobave nga ana e të akuzuarve **BN, NB, BB, AB, AZB, SB, AP dhe ZZ është përcaktuar të jetë 3 (tre) muaj.**

XI. Sipas Nenit 39 Paragrafi 2 të KPK-së afati për pagesën e gjobës nga i akuzuari **MB është përcaktuar të jetë 3 (tre) muaj.**

XII. Të akuzuarit **BN, NB, BB, AB, AZB, MB, SB, AP dhe ZZ**

në këtë mënyrë

Lirohen nga akuza

për kryerjen e veprës së krimit të organizuar, nën Nenin 274 Paragrafi 2 lidhur me Nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), sepse ata nuk kanë marrë pjesë në mënyrë aktive në aktivitetet kriminale apo aktivitetet tjera të një grupi të organizuar kriminal, duke ditur se pjesëmarrja e tyre do të kontribuojë në kryerjen e krimeve të rënda nga grupi i organizuar kriminal.

XII. Sipas Nenit 83 Paragrafi 1 të KPRK koha e kaluar në paraburgim do të llogaritet në dënimin me burgim të shqiptuar kundër tyre , përkatësisht:

- Për BN nga 10 qershor 2011 deri më 1 qershor 2012,
- Për NB nga 10 qershor 2011 deri në 1 qershor
- Për BB nga 10 qershor 2011 deri në 1 qershor 2012
- Për AB nga 13 qershor 2011 deri më 20 nëntor 2012,

- Për AZB nga 11 qershor 2011 deri më 20 nëntor 2012,
- Për SB nga 10 qershor 2011 deri më 20 nëntor 2012.

XIV. Sipas Nenit 83 Paragrafi 1 të KPK-së koha e kaluar në paraburgim nga ana e te pandehurit MB, do të llogaritet në dënimin e shqiptuar kundër tij.

XV. Sipas Nenit 54 paragrafët 1 dhe 3 nën-paragrafi 7 dhe Nenit 60 Paragrafi 1 të KPK, shqiptohet Dënimi plotësues i konfiskimit të darëve të përdorura në kryerjen e veprës penale dhe aktualisht në posedim të Policisë së Kosovës, Departamenti për krim të organizuar Prishtinë / Rajoni i Prishtinës, kundër te pandehurit, MB.

XVI. Sipas Nenit 102 Paragrafi 1 lidhur me Nenin 99 Paragrafi 2, nën-Paragrafi 6 të KPPK-së, shpenzimet e procedurës penale do të paguan pjesërisht nga të akuzuarit si në vijim :

- Nga BN një shumë e vetme prej 150 Eurosh (njëqind e pesëdhjetë),
- Nga NB një shumë e vetme prej 300 Eurosh (treqind),
- Nga BB një shumë e vetme prej 200 Eurosh (dyqind)
- Nga AB një shumë e vetme prej 200 Eurosh (dyqind)
- Nga AZB një shumën e vetme prej 200 Eurosh (dyqind)
- Nga MB një shumë totale prej 150 Eurosh (njëqind e pesëdhjetë),
- Nga SB një shumë e vetme prej 200 Eurosh (dyqind)
- Nga AP një shumë e vetme prej 30 Eurosh (tridhjetë)
- Nga ZZ një shumë e vetme prej 30 Eurosh (tridhjetë).

Shpenzimet e mbetura të procedurës penale do të paguhen nga mjetet buxhetore, sipas Nenit 102 Paragrafi 2 i KPPK-së

GJYKATA THEMELORE E PEJËS

P.nr.38/12

Data 23 janar 2013

Procesmbajtëse

Kryetari i Trupit Gjykses

Nexhmije Mezini

Dariusz Sielicki

Anëtar i Trupit Gjykses

Anëtar i Trupit Gjykses

Malcolm Simmons

Shaban Shala

Mjet Juridik:

Ankesa duhet të shpallet brenda 8 ditësh nga shpallja e këtij aktgjykimi dhe duhet të ushtrohet në gjykatën e shkallës së parë, në pajtim me Nenin 400 Paragrafi 1 i KPPK-së.

Personat e autorizuar mund të ushtrojnë ankesë me shkrim kundër këtij aktgjykimi në Gjykatën e Apelit përmes Gjykatës Themelore në Pejë brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga data e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit, sipas Nenit 398 Paragrafi 1 të KPPK-së.